

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR**

Nr. 229 Prot

Tiranë, më 12/02/2019

**V E N D I M**  
Nr. 71, datë 12.02.2019

**PËR**  
**DISA NDRYSHIME TË VENDIMIT NR. 70, DATË 05.02.2019 “PËR SHPALLJEN E**  
**THIRRJES SË APLIKIMEVE PËR KANDIDATËT PËR ANËTAR TË BORDIT TË**  
**ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN,**  
**QË DO TË VOTOHEN NGA STUDENTËT E IAL-së”**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.782, datë 26.12.2018, shkresës Nr. 322 Prot., datë 14.01.2019, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe vendimit të KIZ të UMT-së me nr.70, datë 05.02.2019 “Për shpalljen e thirrjes së aplikimeve për kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, që do të votohen nga studentët”, Komisioni Institucional Zgjedhor i Universitetit Mjekësisë, Tiranë, për shkak të mungesës së aplikimeve,

**VENDOSI:**

1- Pika 2 e Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor nr. 70, datë 05.02.2019 “Për shpalljen e thirrjes së aplikimeve për kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit ...” ndryshohet si më poshtë:

Pranimi i aplikimeve fillon në datë 06.02.2019 dhe përfundon në datë 18.02.2019, nga ora 9:00 – 15:00.

2- Të ndryshojë fletën e aplikimit duke i bashkëlidhur shtojcat përkatëse (bashkëlidhur këtij vendimi).

3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_ / \_\_\_ /2019

FLETË APLIKIMI

PËR

**KANDIDAT PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, TË MINISTRISË  
PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, QË DO TË VOTOHEN NGA STUDENTËT E IAL-SË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.782, datë 26.12.2018, shkresës Nr. 322 Prot., datë 14.01.2019, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor nr. 71, datë 12.02.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr.70, datë 05.02.2019 “Për shpalljen e thirrjes së aplikimeve për kandidatët për anëtar të bordit të administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që do të votohen nga studentët e IAL-së””,

Unë i/e nënshkruara Z./ Znj. \_\_\_\_\_, atësia \_\_\_\_\_, datëlindja \_\_\_\_\_, punonjës \_\_\_\_\_ pranë \_\_\_\_\_, paraqes aplikimin tim për të qenë Kandidat për anëtar të Bordit të Administrimit, të Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin, që do të votohen nga studentët e IAL-së (Universiteti i Mjekësisë, Tiranë).

**Aplikues**

\_\_\_\_\_  
Emër, Mbiemër, Firmë

*Kjo fletë aplikimi bashkë me shtojcat duhet të depozitohet në Sekretarinë e Komisionit Institucional Zgjedhor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, zyra 303, kat III-te, Godina e Lëndëve Paraklinike, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti Mjekësor i Tiranë*





## **SHTOJCË:**

### **KËRKESAT E PRANIMIT**

#### **a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë;
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

#### **b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati**

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.
- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë.
- Të ketë integritet etik dhe profesional.
- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.
- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;
- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj;
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

### **LISTA E DOKUMENTACIONIT QË DUHET DORËZUAR**

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL ku kandidon;
- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (Curriculum Vitae);
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë Republikës së Shqipërisë, të percillet Vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës/Çertifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);





- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim i lëshuar nga gjykata;
- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;
- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2
- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3
- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.



**SHTOJCA NR. 1/1**

**Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake**

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se \_\_\_\_\_ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_





## SHTOJCA NR. 1/2

### Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se \_\_\_\_\_ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_





### SHTOJCA NR. 1/3

#### **Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati**

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

#### **Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991**

Deklaruesi: \_\_\_\_\_

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se \_\_\_\_\_ anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramentit.

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrimi \_\_\_\_\_